



REPubliKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br. 181/21

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data: / Datum 29.07.2021

VUSHTRRI-VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 nenin 41, paragrafi 2 shkronja “ç” të Statutit të Komunës, nenin 5 të Rregullores (KKV) Nr. 08/2020, protokolli. Nr. 209/20, e datës 29.10.2020 për Dhënien e Dekorativë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datën **29 korrik 2021** merr këtë:

**VENDIM  
PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI”**

1. Me këtë vendim z. Ramiz Tafilaj, veprimtar i shquar Shqiptaro Amerikan, me prejardhje nga Kosova, i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Vushtrrisë.
2. Dorëzimi i këtij titulli z. Tafilaj i bëhet nga Kryetari i Komunës në mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



**Nasuf Aliu**

  
Kryesues i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 182/21

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 29. 07. 2021

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41, paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 korrik 2021**, merr këtë:

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E STRATEGJISË TË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL TË**  
**KOMUNËS SË VUSHTRRIË 2020-2025**

1. Me këtë vendim aprovet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Vushtrrisë 2020-2025.
2. Qëllimi i aprovimit të kësaj strategjie është konsolidimi i infrastrukturës juridike në aspektin e përmirësimit të strukturës ekonomike, rritjen e punësimit, avancimin e, prodhimtarisë, bujqësisë moderne dhe turizmit si dhe krijimin e një ambienti për përshpejtimin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik lokal të Komunës së Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Vushtrrisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit